

NJERËZIT NË MES:

E ARDHMJA E NËNSHTETËSISË
DHE LIRIA E LËVIZJES SË PJESËTARËVE
TË KOMUNITETIT SERB DHE
KOMUNITETEVE TJERA JOSHUMICË
NË KOSOVË

ECMI KOSOVO,
Prill 2018



Mirënjohje

Organizatat anëtare të Koalicionit dëshirojnë të falënderojnë të gjithë të intervistuarit nga institucionet dhe organizatat e ndryshme për gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë dhe të ofrojnë informacione dhe të dhëna të vlefshme për këtë raport.

OJQ-ja që udhëhoqi publikimin e raportit

ECMI Kosova (www.ecmikosovo.org)

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumëetnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëvepruar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

Rr. Nëna Terezë Nr. 20, Apt. 5,
10000 Prishtinë – Kosovë,
Tel. +381 (0) 38 224 473

Rr. Kralja Petra 183 a
38220 Mitrovicë e Veriut – Kosovë,
Tel. +381 (0) 64 433 10 40

Equal Rights for All Coalition

Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC) bashkon shtatë (7) OJQ-të që punojnë në fushën e *sundimit të ligjit* dhe *të drejtave themelore* në bashkëpunim të ngushtë me *nëntëmbëdhjetë (19) OJQ të angazhuara kryesisht në nivel lokal*, me një fokus të veçantë në krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm të OJQ-ve që janë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të grupeve të rrezikuara dhe/ ose të marginalizuara (GRM-ve). Fokus specifik i projektit janë grupet si në vijim: *të gjitha komunitetet jo-shumicë* në Kosovë, *gratë, rinia*, dhe *pjesëtarët e komunitetit LGBT*. Edhe pse punojnë apo shtrijnë veprimet e tyre në tema dhe çështje të ngjashme, këtyre OJQ-ve u mungon bashkëpunimi dhe shpesh përqendrimi i punës së tyre është i ndarë në bazë të grupeve të veçanta të synuara, me të cilat punojnë ato, apo i ndarë sipas rajoneve ku ato shtrijnë aktivitetet e tyre. Me krijimin e një bashkëpunimi strukturor në mes të OJQ-ve të përzgjedhura dhe me ofrimin e mundësive formale për mësim të vazhdueshëm, veprimi gjeneron shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në mes të OJQ-ve (duke përfshirë përvojën në çështjet institucionale), për të forcuar kapacitetet e tyre për avokim me institucionet qendrore dhe komunale, dhe për të rritur dukshmërinë e tyre në terren.

Anëtarët e ERAC janë organizatat e mëposhtme:

- Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë - Lidere e Koalicionit të drejtat e barabarta për të gjithë;
- Qendra për zhvillimin e grupeve shoqërore;
- Qendra për Barazi dhe Liri të pjesëtarëve të komunitetit LGBT në Kosovë;
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore;
- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut;
- Glocal Kosova;
- Centre Qendra për Ndhimë Juridike dhe Zhvillim Regional.

Klauzolë e përgjegjësisë

Përmbajtja e këtij raporti nuk pasqyron opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë Koalicionit të drejta të barabarta për të gjithë—ERAC dhe nuk mundet në asnjë mënyrë të konsiderohet si pikëpamje e BE-së. Ky raport është publikuar si pjesë e aktiviteteve të projektit katër (4) vjeçar "Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë" të financuar nga BE-ja dhe të menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë.

E drejta autoriale

© Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë—ERAC, nëntor 2017. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo lloji mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, incizimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të ECMI Kosovës.



NJERËZIT NË MES:

**E ARDHMJA E NËNSHTETËSISË
DHE LIRIA E LËVIZJES SË PJESËTARËVE
TË KOMUNITETIT SERB DHE
KOMUNITETEVE TJERA JOSHUMICË
NË KOSOVË**



LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE.....	6
KAPITULLI I.....	7
A) SFOND.....	7
B) QËLLIMI DHE METODOLOGJIA.....	10
C) INCIDENTET E FUNDIT.....	11
KAPITULLI II.....	13
A) QASJA E SERBËVE DHE PJSËTARËVE TË KOMUNITETEVE TË TJERA JO-SHUJMICË NË LETËRNJOFTIMET E LËSHUARA NGA AUTORITETET E KOSOVËS.....	13
B) PROCEDURAT PËR TË APLIKUAR DHE PËR TË VËRTETUAR TË DREJTËN PËR NËNSHTETËSI...	15
C) ÇËSHTJET NË LIDHJE ME NXJERRJEN E ÇERTIFIKATËS SË MARTESËS DHE ÇERTIFIKATËS SË NËNSHTETËSISË PËR FËMIJË.....	17
D) RIORGANIZIMI I PROCEDURAVE: UDHËZIMI I RI ADMINISTRATIV PËR KRITERET PËR NËNSHTETËSI.....	19
E) A MUNDEN DISPOZITAT PËR NËNSHTETËSI TË DYFISHTË TË ADRESOJNË ÇËSHTJEN E PASAPORTAVE TË LESHUARA NGA DREJTORIA KOORDINUESE?.....	21
F) REKOMANDIME.....	22
REFERENCAT.....	24

LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE

OSHC-të	Organizatat e shoqërisë civile
ZAMV	Zyra administrative e Mitrovicës së Veriut
ECMI Kosova	Qendra evropiane për çështje të minoriteteve në Kosovë
ERAC	Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë
BE	Bashkimi Europia
MPB	Ministria e punëve të brendshme
UA	Udhëzimi Administrativ
OSBE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë
EULEX	Misioni i Bashkimit European për sundimin e ligjit në Kosovë
DRC	Këshilli danez për refugjatë
UNMIK	Misioni i organizatës së kombeve të bashkuara në Kosovë
OJQ-të	Organizatat joqeveritare
IAPK	Institucioni i avokatit të popullit në Kosovë
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë

KAPITULLI I

A. SFOND

Deri më sot, institucionet publike të Republikës së Serbisë vazhdojnë të operojnë në zonat që janë të banuara me pjesëtarë të komunitetit serb në Kosovë, duke ofruar shërbime që janë thelbësore për këtë komunitet të Kosovës në fushat e arsimit, kujdesit shëndetësor, mbrojtjes sociale, vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve publike. Funkcionimi i këtyre institucioneve së bashku me institucionet publike të Kosovës është një shqetësim i kahershëm në marrëdhëniet Kosovë-Serbi. Qysh në vitin 2006, OSBE-ja kishte publikuar një raport duke i cilësuar ato si "struktura paralele", një term që është futur në përdorim të zakonshëm qysh atëherë.¹ Përveç kësaj, autoritetet e Kosovës kanë kundërshtuar intenzivisht këto struktura duke nënkuptuar se ato veprojnë jashtë nivelit qendror të qeverisjes të Kosovës dhe në këtë mënyrë janë të paligjshme nga standardet e autoriteteve të Kosovës. Kosova ka kushtëzuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura brenda Dialogut të Brukselit për shpërbërjen e këtyre strukturave.² Për më tepër, sa i përket anëtarësisimit të Serbisë në BE, Neni 135 i MSA-së në mënyrë të tërthortë nënkupton që Serbia duhet të angazhohet në gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme në normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, në këtë rast nënkupton edhe procesin e shpërndarjes së funksionimit të institucioneve të saj brenda territorit të Kosovës. Në marrëveshjen e stabilizimit asociimit të Serbisë, neni 135, thotë: "Kjo Marrëveshje nuk do të zbatohet në territorin e Kosovës që aktualisht është nën administrimin ndërkombëtar në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999." Kjo nuk paragjykon statusin aktual të Kosovës ose përcaktimin e statusit të saj përfundimtar sipas asaj Rezolutive.³ Për momentin, pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës vazhdojnë të mbështeten në shërbimet e ofruara nga institucionet publike të Serbisë në Kosovë. Kjo situatë është shumë delikate dhe e ndjeshme. Çdo përpjekje për të shpërbërë këto institucione do të shkaktoje një shqetësim të madh brenda komunitetit serb të Kosovës.⁴

Një nga shërbimet kryesore, të ofruara nga institucionet e Serbisë në Kosovë, është regjistri civil apo shërbimi i ofiçarisë. Pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës kanë vazhduar të përdorin dokumentet e Serbisë edhe pas vendosjes së Administratës së UNMIK-ut (1999) dhe kanë vazhduar ta bëjnë këtë gjë edhe pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës (2008). Në vitin 2000 administrata e UNMIK-ut filloi lëshimin e kartave të identitetit/letënjohtimeve dhe dokumenteve të udhëtimit për banorët e Kosovës. Këto dokumente identiteti dhe udhëtimi nuk konsideroheshin si pasaporta, meqë në të nuk ishte deklaruar nënshtetësia, dhe nuk ishin të lëshuara nga një shtet sovran, këto dokumente thjesht shërbyen për qëllime të udhëtimit dhe identifikimit të banorëve të Kosovës. Këto dokumente ishin në dispozicion për këdo që mund të provonte të ketë jetuar dhe qëndruar në territorin e Kosovës gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë. UNMIK-u ndërpreu lëshimin e letërnjohtimeve dhe dokumenteve të udhëtimit në vitin 2008, pasi që Kosova shpalli pavarësinë dhe vendosi letërnjohtimet dhe pasaportat e veta kombëtare.⁵ Në vitin 2011, u arrit një marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë për të lehtësuar lirinë e lëvizjes. Që atëherë, Kosova ka punuar në rritjen dhe profesionalizimin e sistemit të ofiçarisë/regjistrimit civil dhe të Zyrës për gjendjen civile sikurse edhe në qasjen e lehtësuar për nënshtetësinë

¹ Misioni i OSBE-së në Kosovë, [Strukturat paralele në Kosovë 2006-2007](#).

² Qeveria e Kosovës, [Përmbledhje e shkurtër e Pakos së Marrëveshjeve të Brukselit](#) (27 gusht 2015), f.5.

³ Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit të Serbisë, Neni 135

⁴ Instituti për Zhvillimin Ekonomik të Territorit, [Institucionet publike të Republikës së Kosovës në veri të Kosovës: Çfarë e ardhme na pret?](#) (2017).

⁵ <http://www.refworld.org/docid/3f7d4e3c31.html>

e Kosovës dhe dokumentet e tjera të identitetit, megjithatë, situata mbetet problematike edhe sot, sidomos në komunat me shumicë serbe. Në marrëveshjen midis Kosovës dhe Serbisë për Lirinë e Lëvizjes, neni 2 thuhet se: *Secila palë do të aplikojë, sa më shpejt që të jetë e mundur, një sistem të letërnjoftimeve për udhëtimin kufitar/ndërkufitar të banorëve nga pala tjetër.*⁶

Si pasojë, të gjithë banorët e Kosovës, së paku në teori, kanë qasje në tre forma të dokumenteve të identitetit, dy prej të cilave janë të lëshuara nga Beogradi dhe një nga Kosova:

Pasaportat dhe letërnjoftimet e Republikës së Serbisë: Këto dokumente identiteti u lëshohen shtetasve serbë në të gjithë territorin e Serbisë dhe pranohen në mbarë botën. Ky dokument është pjesë e regjimit të lëvizjes pa viza midis Republikës së Serbisë dhe vendeve të Zonës së Shengenit dhe gjithashtu është i pranuar në Kosovë. Këto pasaporta dhe letërnjoftime lëshohen për qytetarët që banojnë në Serbi, prandaj serbët që banojnë në Kosovë nuk kanë të drejtë të pajisen me to. Banorët e Kosovës kanë qasje në letërnjoftimet e rregullta të Serbisë, nëse ata kanë prona dhe janë banorë të rregullt të Serbisë. Pasaportat dhe letërnjoftimet zyrtare serbe preferohen nga qytetarët e Kosovës sepse ato dokumente nuk i nënshtrohen regjimit të vizave për vendet e zonës së Shengenit, për dallim nga pasaportat e lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë dhe letërnjoftimet dhe pasaportat e lëshuara nga autoritetet e Kosovës.

Pasaportat Drejtorisë Koordinuese të Serbisë për Kosovën dhe letërnjoftimet e lëshuara nga drejtoritë përkatëse të Policisë së Serbisë: Këto dokumente janë lëshuar veçanërisht për pjesëtarët e komunitetit serb që jetojnë në Kosovë që nga viti 2009. Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën është përgjegjëse për lëshimin e pasaportave për qytetarët serbë në Kosovë, Drejtoritë policore në qytetet përkatëse në Serbi janë përgjegjëse për lëshimin e letërnjoftimeve për qytetarët serbë në Kosovë. Këto dokumente nuk janë të përfshira në regjimin pa viza, por pranohen si dokumente zyrtare në mbarë botën.

Pasaportat dhe letërnjoftimet e Kosovës: Këto pasaporta dhe letërnjoftime lëshohen nga autoritetet e Kosovës për të gjithë qytetarët e Kosovës. Dokumentet e identitetit pranohen nga të gjitha shtetet që e kanë njohur Kosovën, por nuk lejojnë udhëtimin pa viza në vendet e zonës Shengen⁷. Letërnjoftimet njihen nga Republika e Serbisë duke u mundësuar mbajtësve të tyre të udhëtojnë prej Kosovës në Serbi dhe anasjelltas.

Në veçanti, Pasaportat e Drejtorisë Koordinuese dhe letërnjoftimet e lëshuara nga Drejtoritë përkatëse policore kanë qenë burimi kryesor i polemikave. Këto dokumente u prezantuan në gusht të vitit 2009 – kur ishte mundësuar liberalizimi i vizave midis Serbisë dhe vendeve të zonës Shengen – dhe janë dokumente që vazhdojnë t'i nënshtrohen regjimit të vizave drejt vendeve të zonës Shengen.⁸ Në parim, pasaportat e Drejtorisë koordinuese mund t'i lëshohen të gjithë qytetarëve të Serbisë në Kosovë. Në praktikë, megjithatë, ato në të shumtën e rasteve i lëshohen pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera në zonat ku veprojnë institucionet paralele serbe. Në vitin 2015, autoritetet e Kosovës deklaruan se pasaportat dhe letërnjoftimet e lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovë dhe Drejtoritë përkatëse policore të Serbisë nuk janë të vlefshme dhe madje janë të paligjshme në Kosovë.⁹ Në fund të prillit 2016, Ministri i Kosovës për dialog, Edita Tahiri kishte udhëhequrë argumentin që të hyj në fuqi ndalimi i të gjitha letërnjoftimeve dhe pasaportave të lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën me seli në Beograd dhe drejtoritë përkatëse policore të Serbisë.¹⁰ Ndalimi ka filluar të praktikohet kryesisht në pranverë të vitit

⁶ Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes, 2011, Neni 2

⁷ Ka vende që nuk e njohin Kosovën si shtet, por pranojnë ose njohin pasaportën e Kosovës. Për shembull, Greqia.

⁸ <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2009:0366:FIN:EN:PDF>

⁹ <http://archive.koha.net/?id=27&l=89172>

¹⁰ <https://www.voal.ch/prishtina-zyrtare-nuk-pranon-pasaportat-e-leshuara-nga-beogradi-per-serbet-e-kosoves/>

2017.¹¹ Ndalimi kufizon serbët e Kosovës dhe personat e tjerë që posedojnë, vetëm, letërnjohtimet e lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën dhe nga drejtoritë përkatëse policore të Serbisë për të udhëtuar në relacionet Kosovë – Serbi. Për më tepër, ndalimi ka qar në konfiskim të dokumenteve të tjera që qytetarëve iu duhen për të pasur qasje në shërbimet e ofruara nga institucionet paralele serbe, siç bie fjala institucionet e kujdesit shëndetësor dhe ato arsimore, si dhe shërbime të tjera¹². Për këto shërbime, banorët kërkojnë dokumente të lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën dhe drejtoritë përkatëse policore të Serbisë .

Sipas marrëveshjes për lirinë e lëvizjes, e cila u arrit në kuadër të Dialogut të Brukselit në vitin 2011, Serbia dhe Kosova ranë dakord të krijojnë një sistem të kartave të identitetit që do të mundësonte udhëtimin e lirë mes Kosovës dhe Serbisë për banorët e të dyja vendeve.¹³ Palët kanë rënë dakord se në kohën kur letërnjohtimet e Kosovës do tu lëshohen të gjithë banorëve të Kosovës, letërnjohtimet e lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën dhe drejtoritë përkatëse policore të Serbisë do të tërhiqen gradualisht. Për shkak të procesit të ngadaltë të ofrimit të qasjes në ID-të/letërnjohtimet e Kosovës për pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës dhe bartësit e tjerë të dokumenteve personale të lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën dhe letërnjohtimet e lëshuara nga Drejtoritë përkatëse policore të Serbisë kanë mbetur në përdorim si e vetmja mënyrë për serbet e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera jo-shumicë për të hyrë dhe dalë nga territori i Kosovës¹⁴. Gjithashtu ekzistojnë variante të ndryshme rajonale për sa i përket zbatimit të marrëveshjes. Ka pasur një progres në krijimin e qasjes për letërnjohtimet e Kosovës në komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibrit. Banorët e katër komunave veriore, megjithatë, duhet të mbështeten në tre zyrat në fshatrat e largëta, dhe tek Zyra administrative e Mitrovicës Veriore, ZAMV, për marrjen e letërnjohtimeve të Kosovës¹⁵. Një ndërlikim tjetër është se shërbimet publike të ofruara nga institucionet paralele të Serbisë dhe kompanitë e tjera publike si shërbimet e postës dhe bankave mbeten të qasshme vetëm nëpërmjet letërnjohtimeve të lëshuara nga drejtoritë përkatëse policore të Serbisë dhe pasaportave të lëshuara nga Zyra koordinuese e Serbisë.¹⁶

Negociatat ndërmjet Kosovës dhe Serbisë kanë arritur faza të reja të zbatimit të marrëveshjeve dhe si rezultat i kësaj është rritur nevoja dhe kërkesa për letërnjohtime të Kosovës në mesin e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës dhe komuniteteve të tjera jo-shumicë.¹⁷ Prandaj, bojkotimi i regjistrimit të banesave dhe regjistrimit të popullësisë në vitin 2011 nga serbët e Kosovës dhe disa pjesëtarë të tjerë të komuniteteve joshumicë¹⁸ po kthehet tani në procedura burokratike, për të pas qasje dhe/apo për tu kualifikuar për marrjen e letërnjohtimit të Kosovës dhe për të dëshmuar qëndrimin dhe vendbanimin në Kosovë. Autoritetet e Kosovës nuk kanë të dhëna për shumë nga pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës dhe për vendbanimet e tyre në territorin e Kosovës, por problemi pritet të trajtohet për shkak të kthimit të kopjeve të librave të regjistrimit civil nga Serbia¹⁹.

¹¹ <http://www.radiokontaktplus.org/vesti/gradani-sa-srpskim-dokumentima-na-kosovu-u-problemu/10354>

¹² Për shkak të mbajtjes së këtyre dokumenteve nga oficerët e policisë. Gjithashtu gjatë vitit 2017 kemi marrë disa raste nga Asistentët ligjorë të ERAC në Kosovën e Veriut, ku qytetarët e katër komunave veriore u ankuan se mbeten pa shërbime shëndetësore për shkak të mos marrjes së kartelave shëndetësore nga Serbia.

¹³ Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes, 2011, Neni 2

¹⁴ Arsyeja është se kërkesa për shtetësi u mohua, ose se zyrat e gjendjes civile nuk ishin themeluar ende në 3 komunat veriore, por janë të vendosura në fshatra të largëta. Në rastet e qytetarëve serbë, kjo ishte edhe për shkak të sigurisë, gjuhës dhe arsyeve të kushtueshme për të shkuar në komunat me shumicë shqiptare për të marrë certifikatat e lindjes dhe për të plotësuar kërkesën për letërnjohtimet e Kosovës ose pasaportat

¹⁵ Administratat komunale u zhvilluan në 3 komunat veriore në vitin 2016.

¹⁶ InTER, [Institucionet publike të Republikës së Serbisë në Veri të Kosovës](#), f.16-17

¹⁷ http://ask.rks-gov.net/media/3251/pes_raporti_eng.pdf

¹⁸ http://www.suedosteuropa.uni-graz.at/cse/sites/default/files/papers/musaj_kos_census.pdf

¹⁹ Serbia i ka kthyer librat e regjistrimit civil, por autoritetet kosovare shumë pak po i përdorin ato për të për të përditësuar informacionin e regjistrimit ose për të nxitur procedurat e komuniteteve serbe dhe jo-shumicë për të marrë karta identiteti, pasaporta ose shtetësi. Problemi është kryesisht i pranishëm në komunat me shumicë serbe të veriut.

B. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

Ky dokument politikash do të shqyrtojë më tej kompleksitetin në lidhje me nënshtetësinë dhe lirinë e lëvizjes për pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës dhe komuniteteve të tjera jo-shumicë. Megjithatë studimi do të bëhet përmes një perspektive ligjore, politike dhe shoqërore, perspektiva ligjore do të jetë mbizotëruese në lidhje me çështjet që lidhen me dokumentacionin. Bazuar në këtë, do të ofrohen rekomandime për të ndihmuar politikë-bërësit me këshilla dhe mënyra për të kapërcyer kompleksitetin rreth përdorimit të letërnjoftimit serb në Kosovë. Për më tepër, në krahasim me studimet e mëparshme në këtë temë, ky dokument i politikave do të shqyrtojë më nga afër çështje teknike të problemeve ekzistuese për marrjen e nënshtetësisë dhe letërnjoftimit të Kosovës. Qëllimi i këtij dokumenti është që të hedh dritë mbi kornizat juridike dhe institucionale që janë faktorë kryesorë për zgjidhjen e kompleksitetit të çështjeve ekzistuese për marrjen e nënshtetësisë dhe letërnjoftimit të Kosovës. Siç u përmend, grup i fokusit në këtë dokument politikash do të jetë komuniteti serb në Kosovë, megjithatë, pjesëtarët e komuniteteve të tjera jo-shumicë, kryesisht romë, boshnjakë, goranë, ashkali dhe egjiptianë janë përbërës me probleme të ngjashme. Në shumë raste, pjesëtarët e komuniteteve të tjera jo-shumicë që janë privuar nga e drejta e tyre për nënshtetësi ose liri të lëvizjes, janë banorë të komunave me shumicë serbe. Megjithatë, shumë pjesëtarë të komuniteteve jo-serbe që jetojnë gjithandej në Kosovë kanë zgjedhur letërnjoftimet e lëshuara nga drejtoritë përkatëse policore të Serbisë, si për shembull pjesëtarët e komunitetit rom që jetojnë në Mitrovicën jugore, pjesëtarët e komunitetit goranë që jetojnë në komunën e Dragashit, si dhe në komuna të tjera që janë kryesisht të banuara nga pjesëtarët e komunitetit serb.

Ky raport për hulumtimin e politikave bazohet në hulumtimin e burimeve të mëposhtme, duke përfshirë: Udhëzimet administrative të Ministrisë së punëve të brendshme; Ligjin për shtetësinë e Kosovës; Marrëveshjen për lirinë e lëvizjes si pjesë e Dialogut të Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë; dhe Raportet mbi zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit të publikuara nga Zyra e Kryeministrit. Gjithashtu në Raport janë përfshirë edhe studime të mëparshme përkatëse nga organizata të tjera të shoqërisë civile. Hulumtimi është plotësuar me intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të organizatave dhe institucioneve relevante, siç është Institucioni i Avokatit të popullit në Kosovë; Zyra administrative e Mitrovicës Veriore; Komuna e Mitrovicës së Jugut, Zyra e gjendjes civile; përfaqësuesit e OJQ-së Aktiv; dhe përfaqësuesit e Këshillit danez për refugjatë. Janë kontaktuar edhe përfaqësuesit e Ministrisë së punëve të brendshme dhe Ministrisë së dialogut, por—marrë parasysh se temat në lidhje me shtetësinë dhe lirinë e lëvizjes për pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës shihen si tema politike, ata nuk ishin të gatshëm të japin intervistë, sepse— në të vërtetë—koha e intervistës ishte gjatë fushatës për zgjedhjet qendrore në Kosovë. Ne gjithashtu u përpoqëm të caktojmë një takim me Agjencinë e Regjistrimit Civil në Prishtinë, që është përgjegjëse për të gjitha Zyrat e Gjendjes Civile në Kosovë, megjithatë, pavarësisht shumë përpjekjeve, nuk arritëm të organizojmë një takim me ta. Për më tepër, mediet e Kosovës dhe ato serbe, të cilat mbuluan gjerësisht këtë temë, përdoren si referenca në këtë Raport të hulumtimit të politikave.

C. INCIDENTET E FUNDIT

Në korrik të vitit 2017, Policia e Kosovës konfiskoi 918 libreza të reja shëndetësore, të institucioneve paralele serbe që ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor, në vendkalimin kufitar Dheu i Bardhë. Librezat ishin duke u sjellë nga Serbia nga Drejtori i degës së Gjilanit për fondin e sigurimeve shëndetësore të Republikës së Serbisë. Librezat shëndetësore ishin të destinuar për serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të cilët posedojnë pasaporta të Drejtorisë koordinuese të Serbisë për Kosovën ose letërnjoftime të lëshuara nga drejtoritë përkatëse policore të Serbisë. Librezat shëndetësore u japin të drejtë dhe/apo u mundësojnë bartësve të tyre qasje në shërbimet shëndetësore pranë institucioneve paralele serbe. Siç është raportuar nga mediet, arsyeja për konfiskimin e librezave shëndetësore ishte se komunat e Kosovës në këto libreza ishin të referuara "komuna e Gjilanit, si komunë e Republikës së Serbisë". Zyrtarët e Policisë së Kosovës kanë shpjeguar se këto libreza shëndetësore janë të kundër ligjshme, pasi që komuna e Gjilanit nuk gjendet në Republikën e Serbisë por në Republikën e Kosovës.²⁰ I njëjti arsyetim ishte dhënë edhe në situatën e bllokimit të vendkalimeve kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në lidhje me letërnjoftimet e Drejtorive policore të Serbisë²¹, ku shkruajnë qytetet e Kosovës sikur të jenë qytete të Republikës së Serbisë. Megjithatë arsyetimi i paligjshmërisë është i arsyeshëm, krijon një situatë kontradiktore dhe konfliktuale pasi që serbët e Kosovës kanë qasje të kufizuara në shërbimet e regjistrit civil të Kosovës, për shkak të mungesës së shërbimeve të ofruara nga institucionet e Kosovës në pjesë të caktuara të territorit të Kosovës, veçanërisht në komunat me shumicë serbe. Kështu, ndalesa e dokumenteve serbe pengon lirinë e lëvizjes së serbëve të Kosovës brenda dhe jashtë Kosovës dhe kufizon qasjen në të drejtat dhe shërbimet themelore të ofruara nga institucionet serbe në Kosovë²².

Nga këndvështrimi zyrtar i Kosovës, çështja lidhur me kartat e identitetit të lëshuara nga Drejtoritë përkatëse policore të Serbisë, është se ato i referohen komunave të Kosovës si komuna të Republikës së Serbisë në territorin e Kosovës. Megjithatë, kartat e identitetit ose pasaportat e lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën në Beograd, për serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera jo-shumicë, janë thelbësore për qasjen në shërbimet e ofruara nga institucionet paralele serbe. Përafërsisht 8,000 banorë të 4 komunave veriore janë të punësuar në institucionet paralele të Republikës së Serbisë dhe rreth 90,000 banorë përfitojnë nga shërbimet që ofrojnë këto institucione, veçanërisht në kujdesin shëndetësor dhe në arsim.²³ Pagat dhe cilësia e shërbimeve në institucionet publike paralele serbe janë më të larta se në institucionet publike të Kosovës, gjë që është një nga arsyt kryesore pse shumë serbë në Kosovë preferojnë të mbajnë funksionalitetin e institucioneve paralele serbe²⁴. Letërnjoftimet dhe pasaportat e lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën në Beograd dhe drejtoritë policore të Serbisë nuk janë vetëm një garanci për serbët e Kosovës për të lëvizur lirshëm nga Kosova në Republikën e Serbisë, por gjithashtu ofrojnë qasje në disa shërbime që sigurojnë të drejtat themelore si: arsimit, kujdesit shëndetësor dhe mbrojtja sociale²⁵.

²⁰ http://rtvpuls.com/vesti/kosovska_policija_oduzela_918_srpskih_zdravstvenih_kartica/15189#.WWXgDoyae08.facebook

²¹ Pasaportat e Drejtorisë së Koordinimit dhe Kartat e Identitetit të Drejtorisë së Policisë të lëshuara nga autoritetet serbe në Serbi të përshtatshme me ato të qytetarëve të Kosovës. Këto dokumente kanë qytetet brenda territorit të Kosovës të përmendura si qytete të Republikës së Serbisë.

²² Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, si dhe asistentët tanë ligjorë në veri, kanë pranuar raste, ku ata që kanë mbetur pa p.sh. kartat shëndetësore, nuk janë në gjendje të marrin shërbimet shëndetësore.

²³ InTER, [Public institutions of the Republic of Serbia in North Kosovo](#), p. 29

²⁴ Publikim i NGO Aktiv, Analiza e Trendit: Opinioni publik i qytetarëve në Kosovën e Veriut. 2017.

²⁵ Kur dokumente të tilla tërhiqen nga qytetarët që i marrin, ata nuk mund të argumentojnë identitetin e tyre në spitale, shkolla apo shërbime të tjera të ofruara nga institucionet paralele serbe në Kosovë.

Letërnjohtimet e Kosovës, nga ana tjetër, janë më së paku të preferuara për serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera që përdorin institucionet paralele serbe.²⁶ Ndërsa shumë serbë të Kosovës dhe pjesëtarë të tjerë të komuniteteve jo-shumicë tashmë posedojnë letërnjohtimet e Kosovës, shumë banorë, veçanërisht në katër komunat veriore të Kosovës, zgjedhin të mos posedojnë dhe përdorin pasaportë ose letërnjohtim të Kosovës për arsye të ndryshme. Gjë kjo që shpesh nënkupton marrjen e një qëndrimi politik kundër Kosovës si shtet i pavarur. Gjithashtu të rëndësishëm janë stimujt e kufizuar për shkak të përfitimeve të ulëta sociale dhe mundësive të dobëta të punësimit. Megjithatë, me zhvillimin e institucioneve të Kosovës në komunat veriore, rëndësia e përdorimit të letërnjohtimeve të Kosovës për banorët e veriut do të rritet. Është thelbësore që autoritetet e Kosovës të fillojnë të sigurojnë qasje të lehtë në regjistrin civil të Kosovës për banorët e komunave me shumicë serbe.

²⁶ <https://www.rks-gov.net/sq-AL/Qytetaret/Shtetesia/Pages/Leternjoftimi.aspx>

Kapitulli II

A.QASJA E SERBËVE DHE PJESËTARËVE TË KOMUNITETEVE TË TJERA JO-SHUMICË NË LETËRNJOFTIMET E LËSHUARA NGA AUTORITETET E KOSOVËS

Kur analizojmë situatën sa i përket qasjes së serbëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera jo-shumicë në letërnjoftime të Kosovës, ne duhet të bëjmë një dallim midis komunave që ndodhen në jug të lumit Ibër dhe atyre që janë në veri të lumit Ibër²⁷. Në komunat me shumicë serbe të jugut, institucionet publike të Kosovës janë funksionale dhe serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera që jetojnë në këto komuna kanë qasje në shërbimet e administratës komunale dhe zyra të gjendjes civile. Sidoqoftë, edhe në këto komuna ofrohen shërbime nga institucionet dhe kompanitë paralele publike serbe siç u përmend më herët.²⁸

Sipas personelit të ECMI Kosovës në zyrën në Mitrovicën e Veriut, në komunat me shumicë serbe mbizotëron një situatë disi e ndryshme, ku shërbimet ofrohen në fshtrat e kësaj komune, 10-15 km larg ndërtesës së Kuvendit komunal.²⁹ Sot-për-sot, ZAMV-ja është e vetmja zyrë dhe ndërtesë zyrtare ku ofrohen shërbime për qytetarët e Mitrovicës veriore. Deri më sot, tri komunat e tjera me shumicë serbe në veri të Kosovës nuk ofrojnë shërbime të plota administrative dhe civile nën autoritetin e Kosovës. Zyrat për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit civil nuk janë të vendosura akoma në ndërtesat e kuvendit komunal pjesërisht të themeluara, por në vend të kësaj zyrat për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit civil funksionojnë në fshatrat Bistricë (komuna e Leposaviqit), Qabër (komuna e Zubin Potokut) dhe Lipë (komuna e Zveçanit). Për pasojë, kjo ka rezultuar në një boshllëk dhe problem të madh për qasje në letërnjoftimet e Kosovës në këto komuna. ZAMV u krijua në verën e vitit 2012. Kjo zyrë lëshon dokumentacionin e gjendjes civile siç janë certifikatat e lindjes, vdekjes dhe gjendjes martesore sikur që ofron edhe të gjitha shërbimet e tjera që një administratë komunale do të duhej të ofronte sipas ligjit të Kosovës.³⁰ Dallimi ndërmjet Zyrave të Gjendjes Civile dhe Zyrave të Regjistrimit Civil është i rëndësishëm sepse me përjashtim të Mitrovicës së Veriut ku të dyja zyrat janë fizikisht në të njëjtin vend, në tre komunat e tjera veriore Zyrat e Gjendjes Civile janë në fshatrat me shumicë shqiptare ndërsa vetëm Zyrat e Regjistrimit Civil janë në qendrat administrative të komunave. Zyrat e Regjistrimit Civil në tri komunat veriore nuk ofruan shërbimin e ndryshimit të rezidencës dhe as dhënien e patentave. Megjithatë, që nga dhjetori, të gjithë lëshojnë licenca për vozitje³¹. Tani-për-tani, shërbimet për aplikimet për shtetësi të Kosovës, për qytetarët e Mitrovicës së Veriut, ofrohen vetëm në komunën e Mitrovicës Jugore. Kompetencat e kufizuara të qendrave administrative në veri të Kosovës dërgojnë mesazhe të paqarta për serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera që jetojnë në veri, veçanërisht duke pasur parasysh kohezionin social tashmë të vështirë midis shqiptarëve dhe serbëve.³²

²⁷ Sipas të intervistuarit të UNHCR-së (5.3.2018), komunat në jug kanë krijuar administrata komunale të vendosura nën sistemin e Kosovës që nga viti 2008. Për më tepër, integrimi i këtyre komunave në integritetin territorial të Kosovës është bërë siç duhet menjëherë pas luftës nën Administrimin e UNMIK-ut, ku komunat me shumicë serbe të veriut nuk ishin plotësisht nën qeverisjen e administratës së UNMIK-ut. Këto objekte kanë rezultuar me problemet e sotme me administratat nën sistemin e Kosovës në komunat me shumicë serbe të veriut.

²⁸ Misioni i OSBE-së në Kosovë. [Profili i Komuniteteve të Kosovës](#) (2010), f.228-230; Grupi Ballkanik për Hulumtimin e Politikave. [Integrimi i serbëve në Kosovë pas Marrëveshjes së Brukselit](#) (2015).

²⁹ ECMI Kosova, Zyra në Mitrovicën e Veriut, gusht 2017.

³⁰ Intervistë në Zyrën Administrative të Mitrovicës së Veriut, gusht 2017.

³¹ NGO Aktiv Broshura Informative mbi Procedurat për Marrjen e Dokumenteve të Kosovës

³² http://kossev.info/strana/arhiva/na_severu_pocle_sa_radom_kancelarije_kosovske_agencije_za_civilne_registre/10717

Çfarë e bën punën e ZAMV-ve dhe zyreve të gjendjes dhe regjistrimit civil mbrenda komunave me shumicë serbe në Kosovë edhe më pak efektive, janë mungesa e librave përkatës civilë (amzë) të para vitit 1999 dhe kompetencat për përdorimin e tyre. Në kuadër të procesit të dialogut teknik mes Prishtinës dhe Beogradit të lehtësuar nga BE, Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje lidhur me krijimin e një sistemi plotësisht të besueshëm të regjistrimit civil në Kosovë në vitin 2011.³³ Për këtë qëllim, BE-ja ka financuar një sërë projektesh të zbatuara nga Këshilli danez për refugjatë (DRC) në Kosovë. Projekti "Përpunimi i të dhënave të librave të regjistrimit civil" (LRC) u zbatua në dy faza midis viteve 2012 dhe 2014 dhe rezultoi me kthimin në Kosovë të mbi 12,000 regjistrave të gjendjes civile (mbi 2.8 milion dëshmi për lindje, martesë dhe të vdekjeve) që më herët ishin zhvendosur në Serbi dhe përmbajnë informata që kanë të bëjnë me kronologjinë e jetës së një individi që nga periudha e pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1999.³⁴ Regjistrat (librat e regjistrimit civil) u kthyen si fotografi digjitale dhe kopje të shtypura dhe u certifikuan nga Misioni i BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë (EULEX).³⁵ Regjistrat e kthyer pastaj iu dorëzuan autoriteteve të Kosovës nga EULEX-i dhe janë në dispozicion në nivel qendror dhe atë komunal. Sipas Chiara Mossina, Menaxhere e Projektit në DRC, këto veprime përbëjnë një hap të madh për të mbështetur zbatimin e marrëveshjes së 2011 për regjistrat civilë të arritur në dialogun teknik mes Prishtinës dhe Beogradit në përputhje me udhëzimet përkatëse për digjitalizimin e regjistrave civilë.³⁶ Procesi, gjithashtu, do të lehtësojë përdorimin e regjistrave të kthyer civilë bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr. 01/2015 për përdorimin e Kopjeve të certifikuara të regjistrave kryesorë të Statutit Civil (librave amzë) të Kosovës të cilat janë marrë nga regjimi i mëparshëm serb para qershorit 1999,³⁷ duke thjeshtuar procedurën e identifikimit dhe gjetjes së detajeve të gjendjes civile për të gjithë ata që kanë jetuar në territorin e Kosovës gjatë periudhës të cilën e kanë mbuluar regjistrat e kthyer civilë.

Sipas të intervistuarit të OSBE-së, kopjet e regjistrave civilë të kthyer nga qytetet serbe, duhet gjithashtu të ruhen në një bazë të dhënash elektronike. Aktualisht kopjet janë vetëm kopje fizike dhe jo të arritshme nga secila komunë. Megjithatë, kjo reflekton problemin e përgjithshëm në Kosovë me bashkëpunimin ndërkomunal, ku komunat nuk ndajnë të dhëna midis njëri-tjetrit. Për më tepër, nëse ka ndonjë bashkëpunim, nuk bëhet në një platformë elektronike. Ekziston njëfarë dixhitalizimi, me qëllim që të rritet përdorimi elektronik i regjistrave civilë në komuna të ndryshme, për tani ajo mbetet një proces shumë i ngadalshëm³⁸.

Librat e regjistrimit të të kthyerve mbulojnë informacionin vetëm deri në vitin 1999, pasi që më pas librat e UNMIK-ut mbulojnë periudhën 1999 - 2008, por ato nuk ofrojnë informata të plota, pasi që jo të gjithë janë regjistruar në UNMIK, por edhe kështu, të dhënat e pakta që ata kanë nuk përdoren nga autoritetet kosovare. Edhe komuniteti shqiptar ka probleme në këtë drejtim, një rast me një shqipëtar që duhej të rimartohej me gruan e tij pas shpalljes së pavarësisë, sepse martesë e tij ishte regjistruar në regjistrin e UNMIK-ut dhe ekstrakti nga regjistri i UNMIK-ut nuk u konsiderua si një dokument ligjor nga autoritetet e Kosovës. Prandaj, gjatë konferencës për draft raport, znj. Andriq, rekomandimi i saj iu referua përtëritjes së përpjekjeve për shkëmbimin e librave serbë pas vitit 1999 pasi ato përmbajnë shumë më tepër informacion mbi statusin e qytetarëve³⁹.

³³ https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/123383.pdf

³⁴ <http://drc-kosovo.org/past-projects/>

³⁵ <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,11,14>

³⁶ Intervistë me Chiara Mossina, Këshilli Danez për Refushtatë në Kosovë, shtator 2017. Shih [Udhëzimin Administrativ \(MPB\) Nr. 12/2016](#) për Përcaktimin e Procedurës për Digjitalizimin e Regjistrave të Skanuar të Statusit Bazik/themelor.

³⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10643>

³⁸ Intervistë me një përfaqësues të Misionit të OSBE-së në Kosovë, 15.2.2018

³⁹ Milica Andric, NGO Aktiv, në konferencën e draft raportit " Njerëzit në mes ", 1.2.2018

B. PROCEDURAT DHE ÇËSHTJET ME APLIKIMIN DHE VËRTETIMIN PËR SHETËSI

Neni 32⁴⁰ i Ligjit për Shtetësinë e Kosovës fokusohet në mënyrë specifike tek qytetarët e ish Republikës Federale të Jugosllavisë që kanë banuar në territorin e Kosovës. Neni 32.1 thotë: *“Të gjithë personat të cilët më 1 janar 1998 kanë qenë shtetas të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe që me këtë datë e kanë pasur banimin e përhershëm në Republikën e Kosovës konsiderohen shtetas të Republikës së Kosovës dhe regjistrohen si të tillë në regjistrin e shtetasve pa marrë parasysh vendbanimin ose shtetësinë që posedojnë aktualisht.”* Për të rregulluar nenin e mësipërm, është nxjerrë një udhëzim administrativ në vitin 2014.⁴¹ Ka pasur disa mangësi në zbatimin dhe interpretimin e udhëzimeve administrative të cilat kanë çuar në refuzimin e shumë aplikacioneve të shtetësisë dhe dokumenteve të tjera të pjesëtarëve të komunitetit serb dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera jo-shumicë.⁴² Gjatë konferencës për draft raport, përfaqësuesi i Ministrisë për Komunitete dhe të Kthyer, znj. Snežana Karadžić, theksoi problemin që Ligji për Qytetari nuk flet për të kthyerit⁴³. Në këtë raport nuk do të trajtojmë një çështje vendimtare që nuk ka asnjë dispozitë në ligjin e shtetësisë, apo ndonjë dokumenti tjetër ligjërish detyrues për të kthyerit dhe procedurat e tyre të dokumentimit. Kjo e fundit është një çështje në rritje dhe ka nevojë për një hetim tërësor.

Është raportuar se janë refuzuar shumë aplikacione për shtetësi të pjesëtarëve të komunitetit serb dhe të komuniteteve të tjera jo-shumicë. Rastet e raportuara janë nga viti 2014 deri në qershor 2017⁴⁴. Aplikacioni në vete përfshin provimin e të drejtës për shtetësi përmes kriterëve të përcaktuara për banorët e territorit të Kosovës para vitit 1998, në këtë kuptim nuk po fiton shtetësi me dispozita të rregullta për një të huaj. Zyrat e Institucionit të Avokatit të Popullit në Graçanicë dhe Mitrovicë kanë pranuar shumë raste që nga viti 2014 kur aplikacionet për shtetësi ishin refuzuar tme arsyetimin se nuk kanë bazë të pamjaftueshme ose për shkak të keqinterpretimit të Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 05/2014.⁴⁵ Përveç kësaj, disa nga personat që u është mohuar shtetësia dhe dokumentacioni tjetër janë njoftuar vetëm gojarisht pa e mbështetur me ndonjë vendim ku arsyetohet arsyeja e refuzimit. Procedura e aplikimit për shtetësi mund të zgjasë deri në 6 muaj. Sipas UA Nr. 05/2014, një parashtruesi të kërkesës për nënshtetësi, të dhënat e të cilit/cilës nuk janë të regjistruara në regjistrin civil të Kosovës duhet të aplikojë drejtpërdrejt në Ministrinë e punëve të jashtme. Në rast refuzimi, palët mund të ankohen në Agjencinë e regjistrimit civil. Në rast se Agjencia e regjistrimit civil konfirmon refuzimin, kërkuesi mund të parashtrorë ankesë pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe, nëse është e nevojshme, të hapë apo inicojë çështjen në gjykatë, procedurë e cila mund të zgjasë deri në dy vjet.

Sipas zonjës Dimitrijević, përfaqësuese e Zyrës së Avokatit të Popullit në Graçanicë, problemet për sa i përket aplikimeve për nënshtetësi filluan pas zbatimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2014. Kjo ndodhi për shkak të keqinterpretimit të UA në zbatimin e tij nga ana e zyrtarëve që punojnë në Divizionin e shtetësisë, brenda Departamentit të shtetësisë, azilit dhe migracionit të Ministrisë së punëve të brendshme, divizion që ka për detyrë të sigurojë dokumentacionin e shtetësisë dhe

⁴⁰ Ligji për Shtetësinë e Kosovës, Neni 32

⁴¹ Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 05/2014 mbi Kriteret që përmbajnë dëshmi mbi shtetësinë e Republikës Federale të Jugosllavisë dhe banimin e Përhershëm në Territorin e Kosovës më 1 janar 1998.

⁴² Intervistë me znj. Milica Andrić, OJQ Aktiv, gusht 2017. Shih gjithashtu OJQ Aktiv. [Qasja në dokumente në Kosovë: Pengesa kryesore për integrimin e komuniteteve joshumicë](#) (2017).

⁴³ Snežana Karadžić, Këshilltare për Komunitete, Ministria për Komunitete dhe Kthim. 1.2.2018

⁴⁴ Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë dhe rastet e Asistentëve ligjorë të ERAC, 2017

⁴⁵ Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 05/2014 mbi Kriteret që përmbajnë dëshmi mbi shtetësinë e Republikës Federale të Jugosllavisë dhe banimin e Përhershëm në Territorin e Kosovës më 1 janar 1998.

të identitetit për aplikantët. Zonja Dimitrijević thotë se ka raste kur aplikantëve u është refuzuar shtetësia pa ndonjë njoftim dhe procedurë ligjore dhe personat që janë refuzuar besojnë se kjo është bërë për shkak të përkatësisë së tyre etnike të qenit serb i Kosovës ose pjesëtarë i ndonjë komuniteti tjetër jo-shumicë. Në deklaratat e bëra për media, përfaqësuesit e MPB-së kanë mohuar çdo kërkesë dhe apo pretendim që lidh refuzimin e aplikacioneve të shtetësisë me përkatësinë etnike të aplikantit, duke thënë se një diskriminim i tillë nuk praktikohet.⁴⁶

Parashtruesi i kërkesës duhet të ofrojë dëshmi ose siç është përcaktuar me nenin 3 ose nenin 4 të UA Nr. 05.2014, jo nga të dyja nenet. Megjithatë, në zbatimin e Udhëzimit shumica e dokumenteve të listuara në këto dy nene janë kërkuar si dëshmi, përndryshe aplikacioni me siguri do të konsiderohej apo vlerësohej si i pasuksesshëm.

Një ankesë e përbashkët kundër refuzimit të pajustificuar të kërkesave për shtetësi për diku rreth 50 parashtrues pjesëtarë të komunitetit rom është depozituar në Graçanicë. Ka, gjithashtu, shumë raste me parashtruesit pjesëtarë të komunitetit serb, me problematikën e të cilëve është marrë Zyra e Institucionit të Avokatit të Popullit në Mitrovicë⁴⁷. Për më tepër, asistentët ligjorë të ERAC-ut në Kosovën e Veriut janë kontaktuar nga disa qytetarë serbë duke u ankuar lidhur me çështjet e qasjes së dokumentacioneve të Kosovës dhe rastet e mohimit të aplikimit për nënshtetësi⁴⁸. Në të gjitha këto raste, kërkesat për shtetësi u refuzuan përkundër faktit që klientët kishin ofruar të gjithë dokumentacionin/dëshmitë e kërkuara të cilat do të duhej t'i jepnin të drejtën atyre për të marrë dokumentacionin e shtetësisë/identitetit të Kosovës. Në disa raste, aplikimi i parashtruesit është refuzuar me një deklaratë të thjeshtë verbale, pa filluar ndonjë procedurë zyrtare. Për më tepër, zonja Dimitrijević përmend se si serbët e Kosovës, veçanërisht në komunat e veriut, janë konfuz se si t'i kapërcejnë këto çështje në lidhje me juridiksionin, veçanërisht duke pasur parasysh se ata, shpesh, nuk janë të vetëdijshëm ose nuk e kuptojnë mekanikën e sistemeve të Kosovës apo të atyre paralele serbe.⁴⁹

⁴⁶ <http://prishtinainsight.com/access-denied-mag/>

⁴⁷ Institucioni i Avokatit të Popullit në Mitrovicë, Shtator 2017.

⁴⁸ Vesna Ordic, asistente ligjore në ERAC, Mitrovica Veriore, 2017.

⁴⁹ Intervistë me znj. Aleksandra Dimitrijević, Institucioni i Avokatit të Popullit zyra në Graçanicë, gusht 2017

C. ÇËSHJET NË LIDHJE ME CERTIFIKATAT E MARTESËS DHE ATO TË SHETËSISË PËR FËMIJËT

Në kontakt me banorët e komunave me shumicë serbe të veriut, personeli i zyrës së ECMI Kosovës në Mitrovicën e Veriut ka identifikuar dy probleme të veçanta; shqetësimi për marrjen e certifikatave të martesës sipas regjistrimit civil të Kosovës kur njëri prej partnerëve nuk ka dokumente civile të Kosovës dhe shtetësi e Kosovës për fëmijët që janë lindur në Kosovë nga prindërit që nuk janë të regjistruar në regjistrin civil të Kosovës.⁵⁰ Në tekstin më poshtë janë përshkruar disa shqetësime që janë ngritur nga serbët e Kosovës në këto fusha, me dispozitat përkatëse të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës.⁵¹

- ***Qytetarët serbë të martuar me qytetarët e Kosovës nuk mund të aplikojnë për shtetësinë e Kosovës.*** Kriteret specifike për marrjen e shtetësisë së Kosovës për bashkëshortët janë: ata duhet të kenë qenë të martuar ligjërisht për të paktën 3 vjet dhe të kenë jetuar në Kosovë për të paktën një vit.⁵² Në pajtim me ligjin, qytetarët serbë me letërnjoftim ose pasaportë zyrtare serbe kanë të drejtë në shtetësi të Kosovës pas përmbushjes së kriterëve të përcaktuara. Kjo, megjithatë, nuk ka të bëjë me dokumentet e identitetit të lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën dhe drejtoritë përkatëse policore të Serbisë.
- ***Gratë që banojnë në Kosovë, por martohen në zyrat e udhëhequra nga sistemi paralel serb në Kosovë dhe e ndërrojnë mbiemrin e tyre pas martesës, mund të marrin dokumentet e Kosovës vetëm me mbiemrin e tyre të vajzërisë dhe janë të detyruara të mbajnë dy identitete në dy sisteme të ndryshme atij të Kosovës dhe atij paralel serb.***
Çdokush që ka shtetësi të Kosovës dhe martohet me një person nga një vend tjetër, ka të drejtë të mbajë nënshtetësinë e Kosovës përkundër ndryshimit të mbiemrit të tyre. Kur flasim për sistemin serb, duhet të dallojmë qartë sistemin paralel serb në Kosovë dhe sistemin aktual serb në shtetin e Serbisë. Meqenëse Kosova nuk i njeh martesat e regjistruara në sistemin paralel të Serbisë brenda Kosovës, as Republika e Serbisë nuk u jep vulat apostile për certifikatat e lindjes, certifikatat e martesës, etj., shtetasve serbë në Kosovë dhe që kërkohen nga autoritetet e Kosovës për të proceduar dhe regjistruar në regjistrin civil.⁵³ Prandaj, kjo çështje mbetet një problem për bashkëshortet që ndryshojnë emrin e tyre të vajzërisë.
- ***Fëmijët prindërit e të cilëve nuk kanë dokumente identiteti të Kosovës mund të marrin vetëm certifikatën e lindjes, por jo nënshtetësinë.***
Për të qenë në gjendje të fitojnë shtetësinë e Kosovës me lindje në Kosovë, të dy prindërit duhet të jenë qytetarë të Kosovës në kohën e lindjes. Megjithatë, shtetësia mund të merret nëse një prind është shtetas i Kosovës, me kusht që fëmija të lindë në territorin e Kosovës ose nëse "fëmija lind jashtë territorit të Kosovës dhe njëri prind është pa shtetësi ose ka një shtetësi të panjohur."⁵⁴ Një problem tjetër i ndërlidhur është se në shumë raste, fëmijëve të lindur në periudhën 1999-2008 u është mohuar shtetësia për shkak të mos-regjistrimit në procesin e regjistrimit të administruar nga UNMIK-u. Kjo është shumë e zakonshme për faktin se këta

⁵⁰ ECMI Kosova, Zyra në Mitrovicën e Veriut, gusht 2017.

⁵¹ OJQ Aktiv. [Qasja në dokumente në Kosovë: Pengesa kryesore për integrimin e komuniteteve joshumicë](#) (2017), f.29.

⁵² Ligji për Shtetësinë e Kosovës, Neni 11

⁵³ <http://kallxo.com/sfida-e-te-lindurve-ne-serbi-per-te-marre-nenshtetesine-e-kosoves/>

⁵⁴ Ligji për Shtetësinë e Kosovës, Nenet 6 & 7

⁵⁵ "... Shtetësia mund të merret nëse njëri prind është shtetas i Kosovës, me kusht që fëmija të lind në territorin e Kosovës ose nëse" fëmija lind jashtë territorit të Kosovës dhe një prind është pa shtetësi ose ka shtetësi të panjohur ... "pa shtet dhe nënshtetësi të panjohur - nuk llogariten me asnjë dokumentacion të regjistrimit civil.

fëmijë nuk kishin të drejtë në posedimin e letërnjohtimit në atë kohë për shkak të moshës, kështu që prindërit nuk i regjistruan ata. Tani për tani, këtyre fëmijëve u janë lëshuar certifikatat e lindjes, megjithatë pjesa për shtetësi është e fshirë. Kjo nuk është e mjaftueshme për të aplikuar për letërnjohtimin e Kosovës.⁵⁶ Për më tepër, certifikatat e lindjes me vula apostile kërkohen nga autoritetet e Kosovës për të filluar procedurën për shtetësi për fëmijët e lindur në Kosovë por që nuk janë të regjistruar në regjistrat civil të Kosovës por që janë të regjistruar në atë të institucioneve paralele Serbe në Kosovë. Autoritetet serbe megjithatë nuk i japin këto vula apostile për prindërit që kanë nevojë për to me qëllim të aplikimit për shtetësi të Kosovës, pasi Serbia nuk e njeh Kosovën si shtet të pavarur.⁵⁷

- ***Qytetarët më të vjetër se 18 vjeç që aplikojnë për shtetësi duhet të kenë së paku njërin prind që posedon letërnjoftim të Kosovës ose të UNMIK-ut dhe të paraqesin dëshmi të vendbanimit dhe që jetojnë në Kosovë për më shumë se 5 vjet.***

Ligji për shtetësinë e Kosovës, neni 31, i konsideron të gjithë mbajtësit e dokumentacionit të UNMIK-ut pas vitit 1999 si me të drejtë për nënshtetësi të Kosovës, nëse ata kanë qenë rezidentë në territorin e Kosovës nën ish - RFJ; "Çdo person i regjistruar si banor i përhershëm i Republikës së Kosovës në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/13 mbi Regjistrin Qendror Civil konsiderohet shtetas i Republikës së Kosovës dhe regjistrohet si i tillë në regjistrin civil.⁵⁸ " Prandaj, një fëmijë i lindur nga një qytetar i tillë, duhet të ketë të drejtën e lindjes për nënshtetësinë e Kosovës. Megjithatë, asnjë i rritur, mbi moshën 18 vjeç, nuk ka nevojë të ketë njërin nga prindërit e tij shtetas të Kosovës për të qenë në gjendje të aplikojë për shtetësinë e Kosovës. Ekzistojnë vetëm tre baza mbi të cilat njëri mund të fitojë shtetësinë: e drejta sipas lindjes, siç është përmendur më herët; të dy ose një nga prindërit kanë shtetësi kosovare; ose përmes procesit të natyralizimit⁵⁹. Kërkesa e vetme për çdo person të huaj për të aplikuar për shtetësi të Kosovës është të dëshmojë se ka jetuar në Kosovë për 5 vjet ose më shumë⁶⁰. Megjithatë, për qytetarët të cilët janë tashmë 18 vjeç ose më të vjetër dhe kanë lindur në Kosovë, ekziston një rrugë tjetër për të ushtruar të drejtën e tyre për shtetësi. Nëse njëri prej prindërve të parashtruesit të kërkesës ka shtetësinë e Kosovës ose letërnjohtimin e lëshuar nga administrata e UNMIK-ut, atëherë kërkesa mund të parashtrohet nga prindi ose prindërit e aplikuesit dhe kërkesës përveç njëres prej dëshmimeve të përcaktuara; certifikatës së lindjes, certifikatës së shtetësisë, letërnjoftimit ose pasaportës së Kosovës, duhet t'i bashkëngjitet certifikata e lindjes së parashtruesit të kërkesës, që dëshmon se ai/ajo është fëmija i/e tij.^{61,62}

⁵⁶ Intervistë me znj. Milica Andrić, 2017

⁵⁷ <http://kallxo.com/sfida-e-te-lindurve-ne-serbi-per-te-marre-nenshtetesine-e-kosoves/>

⁵⁸ Ligji për Shtetësinë e Kosovës, neni 31

⁵⁹ Intervistë me UCHR, 5.3.2018

⁶⁰ Ligji për Shtetësinë e Kosovës nenet 9 & 10

⁶¹ Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 05/2017, Neni 5

⁶² Lidhur me njerëzit nga ish Republika Federale e Jugosllavisë.

D. PËRMIRËSIMI DHE RACIONALIZIMI I PROCEDURAVE: UDHËZIM I RI ADMINISTRATIV MBI KRITERET PËR SHTETËSI

Pas disa takimeve dhe koordinimit me institucionet qendrore dhe lokale, OSBE arriti të marrë rezultate pozitive për krijimin e një UA të ri. Gjatë përpjekjeve për të bindur nevojën për UA të ri, OSBE sollti rastin e 13 familjeve serbe të kthyer në Lubozhdë, Istog. Për shkak të zhvendosjes fatkeqe këto familje kishin humbur shumicën e dokumentacionit të tyre që vërtetonte qëndrimin e tyre në Istog para vitit 1998. OSBE kishte disa takime me Zyrën e Gjendjes Civile në Istog dhe ishte një urë lidhëse për familjet e të kthyerve për të marrë dokumentacionin e Kosovës, edhe kur ata nuk i plotësonin kushtet bazuar në kriteret e UA të vjetër të vitit 2014.

Në mars të vitit 2017, Kryeministri nënshkroi marrëveshjen për krijimin e një UA të ri që rregullon dëshminë e ish banorëve të Jugosllavisë në territorin e Kosovës. Për më tepër, të gjitha zyrat rajonale të OSBE-së kanë ndjekur zhvillimet në zbatimin e UA-së. Deri më tani rezultatet janë pozitive.⁶³

Në korrik të vitit 2017, ky udhëzim administrativ u zëvendësua me një udhëzim të ri, me qëllim të zgjidhjes së problemeve në lidhje me zbatimin dhe keqinterpretimin e dispozitave të udhëzimit pararendës, ndërsa kompetencat për zbatim u zhvendosën në nivelin lokal.⁶⁴ Përveç kësaj, koha e përpunimit tani është vetëm 30 ditë, krahasuar me 6 muaj siç ishte me UA të vjetër të vitit 2014. Nëse vendimi mbi shtetësinë nuk mirret brenda 30 ditëve, aplikanti mund të apelojë tek institucioni përgjegjës.⁶⁵ Qëllimi kryesor i këtij udhëzimi administrativ është të rregullojë kriteret në lidhje me dëshmitë për të vërtetuar shtetësinë ose vendbanimin në territorin e Kosovës para datës 1 janar 1998 dhe të lehtësojë zbatimin e parashkrimit ligjor i cili u garanton qytetarëve ose banorëve të Ish-Republikës Federale të Jugosllavisë, në territorin e Kosovës para datës 1 janar 1998, të drejtën e shtetësisë së Kosovës.

Në krahasim me Udhëzimin e vjetër administrativ, nenet 3 dhe 4 kanë zhvendosur vendet duke përfshirë ndryshimet e nevojshme me një gjuhë më të qartë dhe mundësi më të gjera për dëshminë e provave.

Neni 3 i udhëzimit administrativ paraqet katër kriteret të ndryshme, nga të cilat parashtruesi i kërkesës për shtetësi duhet të plotësojë të paktën një për të qenë në gjendje të aplikojë për shtetësinë e Kosovës:

- personi ka lindur në Kosovë, ose nëse njëri prind ka lindur në Kosovë para 1 janarit 1998;
- personi ka banuar në Kosovë për një periudhë të pandërprerë prej së paku 5 vjetësh para 1 janarit 1998;
- personi është detyruar të largohet nga Kosova para 1 janarit 1998 dhe për këtë arsye nuk ka pasur mundësi t'i plotësojë kushtet për të qenë banorë të përcaktuara në paragrafin 3.2 të këtij neni;
- personi ka qenë fëmijë i varur që nuk i ka plotësuar kushtet nën moshën 18 vjeçare ose nën moshën 23 vjeçare nëse ai/ajo ka qenë duke vijuar shkollimin e rregullt në ndonjë institucion arsimor para 1 janarit 1998 dhe nëse prindërit e tij/saj bëjnë pjesë në paragrafët 3.1, 3.2 ose 3.3 të këtij neni ose janë të regjistruar sipas nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/13.

⁶³ Intervistë me Misionin e OSBE-së në Kosovë, 15.2.2018

⁶⁴ [Udhëzimi Administrativ \(MPB\) Nr. 05/2017](#) mbi Kriteret që përmbajnë dëshmi mbi shtetësinë e Republikës Federale të Jugosllavisë dhe banimin e Përhershëm në Territorin e Kosovës më 1 janar 1998.

⁶⁵ Intervistë me UNCHR, 5.3.2018.

Neni 4 i UA-së përcakton dokumentet e kërkuara, ku të paktën njëri është i nevojshëm, për të vërtetuar posedimin e shtetësisë ose të vendqëndrimit gjatë periudhës së ish-RFJ-së para 1 janarit 1998:

Pala për vërtetimin e shtetësisë së ish RFJ -së duhet ta sjell njërin nga dokumentet si në vijim:

- certifikatën e shtetësisë të ish RFJ-së;
- certifikatën e lindjes apo certifikatën e martesës të ish RFJ-së;
- pasaportën e ish RFJ-së apo letërnjoftimi e ish RFJ-së;
- çdo dokument tjetër që vërteton shtetësinë e ish RFJ-së. (Librezë ularake, shëndetësore, patentë shofer, indeks studentor apo librezë e punës).

Kur një person (palë) ka provuar njërin nga kriteret e mësipërme, atij/asaj i kërkohet gjithashtu që të sigurojë dëshmitë e identifikimit si në vijim me qëllim që të vërtetojë se dokumentet e tij/saj janë reale:

- një dokument zyrtar identifikimi ose pasaportë, me foto ose gjurmë gishtash, të ndonjë vendi ose institucioni të tij;
- ose si alternativë të ndonjë agjencie ose institucioni të Kombeve të Bashkuara;
- dhe prova të tjera të besueshme ose dëshmitarë të besueshëm;
- nëse asnjëra nga këto nuk është e aplikueshme, ekzistojnë dokumente të tjera të pranueshme që janë paraqitur si provë (shih shtojcën e dokumenteve të pranuar).

Ky udhëzim administrativ hyri në fuqi në mes të korrikut të vitit 2017, dhe për këtë arsye, shumë pak mund të thuhet se si është duke funksionuar në praktikë. Megjithatë, udhëzimi i ri administrativ është më i saktë dhe më i detajuar se ai i mëparshmi. Për më tepër, UNCHR në Kosovë dhe GIZ kanë organizuar trajnime gjatë vjeshtës 2017 me zyrtarët komunal lidhur me UA të ri Nr. 05/2017.⁶⁶ Duke u bazuar në UA të ri, çdo individ që ishte shtetas i mëparshëm/i tanishëm i Kosovës, i cili dëshiron të kërkojë dhe/apo aplikojë për shtetësinë e Kosovës, duhet t'i mundësohet kjo e drejtë. Më konkretisht, shtetësia mund të vërtetohet nga një listë e zgjeruar e dëshmitarëve të dokumentuara; me një minimum prej 2 dëshmitarësh para noterit, dhe kjo mund të paraqitet si provë. Për më tepër, pasi që kompetencat për regjistrat dhe aplikimet për shtetësi tani janë zhvendosur në përgjegjësitë e nivelit lokal, çdonjëri mund të shkojë drejtpërdrejt në zyrat lokale të regjistrat civil (ofiqari) të vendit të tyre të lindjes me evidencën përkatëse të përcaktuar në kriteret e UA-së dhe të aplikojë për shtetësi dhe dokumente të tjera personale. Kjo edhe një herë tregon rëndësinë e krijimit të administratave funksionale në nivelin lokal sipas ligjeve dhe sistemit të Kosovës në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës. Edhe nëse e lëmë mënjanë kompleksitetin praktikë të udhëtimit në komuna të tjera, sipas znj. Andrić, shumë serbë të Kosovës kanë frikë për sigurinë e tyre nëse janë të lindur në një komunë, që tashmë është, me shumicë shqiptare dhe duhet të paraqesin kërkesa në zyrat përkatëse lokale.⁶⁷ Për më tepër, Omudsperson i Kosovës, Hilmi Jashari, është i shqetësuar me faktin se nuk ka gjykatë që mbikëqyr punën e administratës civile dhe parregullsitë që ndodhin në këto institucione. Kjo është shqetësuese pasi shumë probleme lejohen të kalojnë midis gishtërinjve dhe të rezultojnë në pengimin e të drejtave të njerëzve për të pasur qasje në shërbime të caktuara dhe të gëzojnë të drejtën për t'i praktikuar ato.⁶⁸

⁶⁶ Intervistë me përfaqësues të UNCHR-së, 5.3.2018.

⁶⁷ Intervistë me znj. Milica Andrić, OJQ Aktiv, gusht 2017.

⁶⁸ Hilmi Jashari, Avokat i Popullit në Kosovë, konferenca për draft raportin "Njerëz në mes" 1.2.2018

E. A MUNDEN DISPOZITAT E SHETËSISË SË DYFISHTË TË ADRESOJNË ÇËSHTJEN E PASAPORTAVE DHE LETËRNJOHTIMEVE TË LËSHUARA NGA DREJTORIA KOORDINUESE PËR KOSOVËN DHE DREJTORITË PËRKATËSE POLICORE TË SERBISË?

Në shumë qarqe, është raportuar se e drejta për shtetësi të dyfishtë, e parashikuar në Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet pasuese, në të vërtetë i lejon pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës të mbajnë pasaportat e lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën dhe letërnjohtimet e lëshuara nga drejtoritë përkatëse policore të Serbisë dhe të marrin shtetësinë e Kosovës.

Qytetarët e Kosovës kanë të drejtë për shtetësi të dyfishtë ose të shumëfishtë, siç garantohet me Ligjin për Shtetësinë e Kosovës. Neni 3 i Ligjit për Shtetësinë e Kosovës thotë: “Një qytetar/shtetas i Republikës së Kosovës mund të jetë edhe shtetas i një ose më shumë shteteve të tjera. Fitimi dhe mbajtja e shtetësisë tjetër nuk rezulton në humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës”.⁶⁹ Ekziston një tolerancë e veçantë për shtetësinë e dyfishtë dhe të shumëfishtë në Kosovë, pasi çdo person mund të mbajë shtetësinë e një shteti tjetër pasi të ketë fituar shtetësinë kosovare. Nxitja për shtetësinë e dyfishtë u zhvillua me një konsideratë të lartë për serbët e Kosovës duke pasur parasysh që pjesëtarët e këtij komuniteti do të jenë grupi kryesor që praktikon këtë të drejtë.⁷⁰ Megjithatë, ky nuk është rasti deri tani dhe nuk pritet që të ndryshojë nëse mosmarrëveshjet politike midis Kosovës dhe Serbisë vazhdojnë të ekzistojnë. Thelbi i problemit është se ligji i Kosovës nuk i konsideron pasaportat ose letërnjoftimet e lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën dhe drejtoritë përkatëse policore si të barabarta me pasaportat dhe letërnjohtimet zyrtare serbe. Në fakt, këto dokumente nuk janë të mbuluara me ligjin e shtetësisë së Kosovës, pasi që të njëjtat pretendojnë se Kosova është pjesë e Serbisë. Një shembull i kësaj janë letërnjohtimet dhe pasaportat e lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën (në Beograd) dhe drejtoritë përkatëse policore të Serbisë për qytetarët e Kosovës, duke e deklaruar qytetin e tyre të banimit si p.sh ‘Mitrovicë e Kosovës, Republika e Serbisë’, ‘Prishtinë, Republika e Serbisë’ dhe qytete të tjera në Kosovë. Duket që kjo të jetë shkaku kryesor për pavlefshmërinë e dokumenteve të këtij lloji në Kosovë. Një zgjidhje për të vërtetuar këto dokumente në Kosovë, do të ishte që ata të mos deklaronin komuna në territorin e Kosovës si pjesë e Republikës së Serbisë. Megjithatë, të gjithë personat që do të qëndrojnë përgjithmonë në territorin e Kosovës, do të vazhdojnë të marrin edhe dokumentacionin e Kosovës, pasi dokumentet e identitetit të Drejtorisë Koordinuese në Beograd dhe Drejtoritë e Policisë në Serbi nuk do të ishin të vlefshme për qytetarët që të kenë qasje në shërbimet publike të ofruara nga sistemi i Kosovës.

⁶⁹ Ligji për shtetësinë e Kosovës, neni 3.

⁷⁰ Observatori i EUDO-së për Shtetësinë. [Raporti mbi Ligjin e Shtetësisë: Kosovë](#) (2015).

F. REKOMANDIME

Ekzistojnë disa probleme që pengojnë në marrjen e shtetësisë dhe në lirinë e lëvizjes për serbët e Kosovës dhe komunitetet tjera joshumicë që marrin dokumentacionin e strukturave paralele serbe. Më poshtë do të paraqesim disa rekomandime për të lehtësuar progresin në të ardhmen:

- Udhëzimi i mëparshëm administrativ shpesh është keqinterpretuar, keqpërdorur dhe zbatuar në bazë të kompetencave të punonjësve që kanë punuar me të, gjithashtu kompetencat për të lëshuar shtetësinë kanë qenë vetëm në nivel qendror, ndërsa me Udhëzimin e ri administrativ kompetencat janë bartur tek autoritetet e nivelit lokal. Tashmë është e nevojshme të organizohen më shumë trajnime për ngritjen e kapaciteteve të personelit në nivelin lokal që po tash e tutje do të zbatojnë Udhëzimin e ri administrativ Nr. 05/2017 dhe që punojnë drejtpërdrejt në zyrat që lëshojnë shtetësinë e Kosovës dhe dokumente të tjera të identitetit.
- Kosova duhet t'i japë prioritet krijimit të administratave komunale plotësisht funksionale në katër komuna veriore, të cilat do t'u mundësojnë qytetarëve në këto komuna të kenë qasje në të gjitha shërbimet në të cilat ata kanë të drejtë, veçanërisht funksionalizimin e zyrave të regjistrimit civil për të aplikuar për shtetësinë e Kosovës dhe dokumente të tjera të personale.
- Në përputhje me marrëveshjet teknike të arritura në Dialogun e Brukselit, Kosova dhe Serbia duhet të garantojnë lirinë e lëvizjes duke lehtësuar procedurat e regjistrimit civil, në radhë të parë për pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera që vazhdojnë të mbështeten në institucionet paralele serbe.
- Autoritetet e Kosovës duhet të përqëndrohen më shumë në çështjen e certifikatave të martesës dhe mundësisht të punojnë në nxjerrjen e një udhëzimi administrativ ose një akti tjetër që kërkon të rregullojë kompleksitetin aktual me mosnjohjen e martesave të regjistruara në institucionet paralele serbe brenda Kosovës.
- Çështjet për sa i përket shqetësimeve të sigurisë, shpenzimeve të udhëtimit dhe pengesave gjuhësore, janë ngritur nga shumë njerëz që i kemi intervistuar. Kërkesa për të marrë certifikatën e lindjes, për herë të parë, në komunën e lindjes duhet të adresohet ndoshta duke u mundësuar këtyre personave që të aplikojnë për certifikatat e lindjes në nivelin qendror, në Ministrinë e punëve të brendshme, gjë kjo që u mundëson atyre të mos udhëtojnë në komunat përkatëse të lindjes.
- Kosova dhe Serbia janë pajtuar që të shpërbëjnë strukturat paralele serbe dhe të vendosin institucione që punojnë sipas sistemit dhe ligjeve të Kosovës si një kërkesë e marrëveshjes që të themelohet Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Më e rëndësishmja, të gjitha palët që angazhohen për avancimin e interesave të pjesëtarëve të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera pakicë të Kosovës duhet të rrisin formën e angazhimit drejt zbatimit të Marrëveshjeve të Brukselit pa krijuar boshllëk në mënyrë që qytetarët të gëzojnë të drejtat e tyre themelore.
- Kosova duhet të punojë në zhvillimet e saj të brendshme të vendosura nga BE-ja për perspektivat e saj për liberalizimin e vizave. Liberalizimi i vizave do të shtonte një vlerë të madhe për sa i përket pasaportës së Kosovës dhe do të rezultonte në një nivel shumë më të lartë të interesit

për marrjen e shtetësisë së Kosovës. Posaçërisht personat që posedojnë vetëm pasaportat e lëshuara nga Drejtoria koordinuese e Serbisë për Kosovën ose letërnjoftimet e lëshuara nga drejtoritë përkatëse policore të Serbisë, të cilat gjithashtu i nënshtrohen regjimit të vizave, do të stimulohen dhe inkurajohen për të marrë pasaportën kosovare.

- Ekziston një mungesë e qartë e monitorimit dhe koordinimit të zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit, gjë që ka rezultuar me stagnim të çdo progresi dhe në një tranzicion të zgjatur të Kosovës. BE-ja mund të rrisë përfshirjen e saj për të zbatuar pjesën e implementimit të marrëveshjeve, edhe pse faza e zbatimit është kryesisht proces i brendshëm i Kosovës dhe Serbisë.

Raportet dhe marrëveshjet:

- Strukturat paralele në Kosovë, 2006-2007; <http://www.osce.org/kosovo/24618?download=true>
- Marrëveshja e Stabilizim Asocimit të Serbisë, Neni 135
- Marrëveshja për lirinë e lëvizjes, 2011
- Marrëveshja për lirinë e lëvizjes, 2011, Neni 2
- Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 539/2001, "për caktimin e vendeve të treta shtetasit e të cilave duhet të jenë të pajisur me vizë kur kalojnë kufijtë e jashtëm, dhe të vendeve shtetasit e të cilave përjashtohen nga kjo kërkesë",
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2009:0366:FIN:EN:PDF>
- Profilet e komuniteteve, OSBE, f.228-230;
<https://www.osce.org/kosovo/75450?download=true>
- Dialogu i lehtësuar nga BE: tre marrëveshjet e arritura në Bruksel, 2 korrik 2011;
https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/123383.pdf
- Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, Certifikimi i librave të regjistrit civil; <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,11,14>
- Qasja në dokumente në Kosovë: pengesa kryesore për integrimin e komuniteteve jo-shumicë, f.29;
[http://ngoaktiv.org/uploads/files/Pristup_li%C4%8Dnim_i_putnim_dokumentima%20\(1\).pdf](http://ngoaktiv.org/uploads/files/Pristup_li%C4%8Dnim_i_putnim_dokumentima%20(1).pdf)
- Raporti mbi Ligjin e Shtetësisë: Kosovë, 9.18;
http://cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/34477/EUDO_CIT_2015_03-Kosovo.pdf;sequence=1
- VLERËSIMI I REZULTATEVE TË REGJISTRIMIT TË POPULLSISË NËPËRMJET NJË PYETËSORI/ ANKETE PAS NUMËRIMIT http://ask.rks-gov.net/media/3251/pes_raporti_eng.pdf
- Regjistrimi i popullsisë së vitit 2011 në Kosovë: Regjistrimi i kontestuar i popullsisë në një Shtet të kontestuar, f. 90-91;
http://www.suedosteuropa.uni-graz.at/cse/sites/default/files/papers/musaj_kos_census.pdf

Ligjet dhe Udhëzimet Administrative:

- UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) Nr. 12/2016 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË DIGJITALIZIMIT TË REGJISTRAVE THEMELTARË TË SKANUAR TË GJENDJES CIVILE;
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12900>
- UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) Nr. 01/2015 PËR PËRDORIMIN E KOPJEVE TË CERTIFIKUARA TË REGJISTRAVE ORIGINAL THEMELTAR TË GJENDJES CIVILE TË KOSOVËS, TË CILAT JANË MARRË NGA ISH-PUSHTETI SERB, PARA QERSHORIT TË VITIT 1999;
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10643>
- Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion;
<https://mpb.rks-gov.net/Departments.aspx>

- Ligji për Shtetësinë e Kosovës, Neni 11;
- Ligji për Shtetësinë e Kosovës, Nenet 6 & 7;
- Ligji për Shtetësinë e Kosovës, Nenet 9 & 10;
- Ligji për Shtetësinë e Kosovës;
- Ligji për Shtetësinë e Kosovës, Neni 3;
- Ligji për Shtetësinë e Kosovës, Neni 32;
- UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) Nr. 05/2014 PËR KRITERET QË PËRBËJNË DËSHMI PËR SHETËSINË E ISH-RFJ-së DHE BANIMIN E PËRHERSHËM NË TERRITORIN E KOSOVËS MË 1 JANAR 1998;
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9885>
- UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) Nr. 05/2017 PËR KRITERET QË PËRBËJNË DËSHMI PËR SHETËSINË E ISH-RFJ-së DHE BANIMIN E PËRHERSHËM NË TERRITORIN E KOSOVËS
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14900>

Institucionet, organizatat dhe intervistat:

- Letërnjohtimet e Kosovës;
<https://www.rks-gov.net/sq-AL/Qytetaret/Shtetesia/Pages/Leternjoftimi.aspx>
- Dijana Hasani, ECMI Kosova, Zyra në Mitrovicën e Veriut, gusht 2017;
- Zyra Administrative në Mitrovicën e Veriut, gusht 2017;
- Këshilli Danez për Refugjatë, Përpunimi i të Dhënave të Librave të Regjistrimit Civil;
<http://drc-kosovo.org/past-projects/>
- Chiara Mossina, Këshilli Danez për Refugjatë në Kosovë, shtator 2017
- Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë;
<http://www.ombudspersonkosovo.org/en/mission>
- Aleksandra Dimitrijević, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, zyra në Graçanicë, gusht 2017
- Milica Andrić, OJQ Aktiv, Mitrovicë e Veriut gusht 2017.

Mediet në Kosovë dhe Serbi:

- http://regionalnirazvoj.org/upload/Publication/Documents/2017_08/Public_institutions_of_the_Republic_of_Serbia_in_North_Kosovo.pdf
- <http://archive.koha.net/?id=27&l=89172>
- <http://kallxo.com/sfida-e-te-lindurve-ne-serbi-per-te-marre-nenshtetesine-e-kosoves/>
- <https://www.voal.ch/prishtina-zyrtare-nuk-pranon-pasaportat-e-leshuara-nga-beogradi-per-serbet-e-kosoves/>
- <http://www.radiokontaktplus.org/vesti/gradani-sa-srpskim-dokumentima-na-kosovu-u-problemu/10354>
- <http://www.gazetaexpress.com/en/news/implementation-of-brussels-agreement-has-stagnated-170854/>

- http://rtvpuls.com/vesti/kosovska_policija_oduzela_918_srpskih_zdravstvenih_kartica/15189#.WWXgDoyae08.facebook
- <http://arhiva.mup.gov.rs/domino/zakoni.nsf/Identity%20Card%20Law.pdf>
- http://regionalnirazvoj.org/upload/Publication/Documents/2017_08/Public_institutions_of_the_Republic_of_Serbia_in_North_Kosovo.pdf
- http://kossev.info/strana/arhiva/na_severu_pocele_sa_radom_kancelarije_kosovske_agencije_za_civilne_registre/10717

